



Prishtine, data: 16.03.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 5599 dt. 13.12.2017 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: Gëzim Dragusha me adrese Radoste, Komuna Rahovec, merr këtë vendim :

AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave për Gëzim Dragusha me adrese Radoste, Komuna Rahovec, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj Gëzim Dragusha, me adrese Radoste, Komuna Rahovec, KPMM ka lëshuar Aktvendim me nr. 5599 dt. 13.12.2017.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.13.12.2017 dhe me dt.10.12.2018 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .



Ramiz Krasniqi
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE (KPMM) në pajtim me nenin 79 paragrafët 3, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

1. Ndaj: **Gëzim Dragusha** person fizik me adresë; Radoste, Komuna Rahovec.
2. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 3 i shqiptohet gjoja administrative për seperimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e jashtëligjshëm të resurseve minerare e cila është e barabartë me trefishin e shumës së rentave minerare prej **131.10 m³** të cilat duhet të paguhen për mineralet e seperuara dhe shfrytëzuara ose eksploatuara të rërës dhe zhavorrit në shumën prej **491.61 € (katërqind e nëntëdhjet e një euro e gjashtëdhjet e një cent)**.
3. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoja administrative për zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar pa posedimin Lejes për Aktivitet të Veçanta Seperacioni dhe Licencës së Shfrytëzimit në shumën prej **5,000.00 € (pesë mijë euro)**.
4. Dhe në pajtim me nenin 79 paragrafi 5 shqiptohet gjoje administrative në mënyrë kumulative (grumbulluese) lidhur me paragrafet 3 dhe 4 të këtij neni e cila është në shumën e përgjithshme prej **5,491.61€ (pesë mijë e katërqind e nëntëdhjet e një euro e gjashtëdhjet e një cent)**.
5. Pala ka 15 ditë afat nga data e hyrjes në fuqi të këtij aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën 4 të dispozitivit në këtë xhirëlllogari: **1000430070005950**.

Arsyetim

Gjatë inspektimit të aktiviteteve të jashtëligjshme minerare me datën 09.11.2017. Inspektorati i Minerave i KPMM-së, në bazë të autorizimeve dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Minerave ka konstatuar se personi fizik Gëzim Dragusha është hasur duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar. Inspektimi është bërë në lokacionin e objektit minerar në Radoste, Komuna e Rahovecit. Inspektimi është bërë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës Njësia Speciale Gjakovë. Gjatë inspektimit Inspektorët e Minerave kanë konstatuar se personi fizik Gëzim Dragusha ka kryer aktivitet të jashtëligjshëm minerar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale si dhe Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, duke e përkuftizuar edhe lokacionin me koordinata ku ishte duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar. Lloji i mineralit që jeni hasur duke e seperuar, përpunuar dhe shfrytëzuar në mënyrë të jashtëligjshme është rërë dhe zhavorr.

Inspektorët e Minerave kanë konstatuar se personi fizik Gëzim Dragusha aktivitetin e operimeve të jashtëligjshme minerare e zhvillonte në lokacionin me këto koordinata:

Nr.	Y	X	Z (m)
1.	7460759	4694726	333
2.	7460750	4694751	333
3.	7460721	4694724	334
4.	7460731	4694708	333

Në lidhje me këto koordinata personi fizik Gëzim Dragusha nuk posedon Leje për Aktivitet të Veçanta Seperacioni si dhe Licencë të Shfrytëzimit të lëshuar nga organi kompetent i KPMM-së.

Makineria e angazhuar në kryerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar ishte:

- Seperacioni Statik me katër fraksione
- Kamion Transportues Mercedes pa tabela.
- Ekskavator me ngjyrë portokalltë.

Personi fizik Gëzim Dragusha është urdhëruar me anë të urdhëresës të lëshuar nga Inspektorët në datën e inspektimit që menjëher të ndërprej aktivitetin e jashtëligjshëm minerar.


Me datën 23.11.2017, Departamenti i Gjeodezisë i KPMM-së, ka kryer matjet gjeodezike në lokacionin e operimit ilegal të personi fizik Gëzim Dragusha dhe është konstatuar fusha e deponimit prej **103.867m²** dhe sasia e mineraleve të deponuara prej **131.10 m³**.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi t'i dergohet:

- Arkivës së KPMM-së,
- Departamentit të Financave të KPMM-së,
- Palës.



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale